

VLERËSIMI I KOMUNITETIT PËR QEVERISJEN

RAPORT BASHKIA BERAT



RAPORT

VLERËSIMI I KOMUNITETIT PËR QEVERISJEN 2016

BASHKIA BERAT

SHËNIM I RËNDËSISHËM

Ky raport u përgatit me:

Mbështetjen financiare dhe teknike të Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID). Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Dhe me

Mbështetjen financiare dhe teknike të Njesisë së Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women), në kuadër të programit “Lidershipi dhe Pjesëmarrja Politike”. Ky program është financuar nga Qeveria Suedeze nëpërmjet Fondit të Koherencës së Kombeve të Bashkuara dhe është pjesë e “Programit të Bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara 2012-2016”. Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e UN Women, të Agjencive të Kombeve të Bashkuara apo të Qeverisë Suedeze.

AUTORËT

Raporti u përgatit dhe u hartua nga ekspertët e Qendrës Aleanca Gjinore për Zhvillim në bashkëpunim me Shoqatën për Integrimin e Zonave Informale (SHIZI) me mbështetjen dhe asistencën e:

Laureta MEMO, Eksperte për Angazhimin Qytetar dhe Komunikimin, USAID/Projekti i Planifikimit dhe Qeverisjes Vendore

Fiorela SHALSI, Menaxhere e Programit Kombëtar “Lidershipi dhe Pjesëmarrja në Politikë”, UN Women

Të drejtat e publikimit

© Aplikimet për lejen për të riprodhuar ose përkthyer të gjithë ose një pjesë të këtij studimi duhet bërë në zyrën e GADC-së me adresë:

Rr. Abdyl Frashëri”, P.10/1, shk.1, ap.3

E-Mail: gadc@gadc.org.al

www.gadc.org.al

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|--|----|
| MIRËNJOHJE..... | 5 |
| SHKURTIME..... | 6 |
| 1. HYRJE..... | 7 |
| 2. PËRMbledhje EKZEKUTIVE | 8 |
| 3. PROFILI I BASHKISË BERAT | 9 |
| 4. METODOLOGJIA | 11 |
| 5. PËRSHKRIM I PROJEKTIT..... | 13 |
| 6. PËRMbledhje E REZULTATEVE..... | 16 |
| 7. GJETJET KRYESORE | 18 |
| 7.1 GJETJET NË QYTET..... | 18 |
| 7.1.1 Shërbimet Publike – Cilësia dhe Efiçenca | 18 |
| 7.1.2 Mirëqeverisja dhe Demokracia Vendore | 18 |
| 7.1.3 Zhvillimi Ekonomik Vendor | 19 |
| 7.1.4 Të drejtat e njeriut në nivel lokal..... | 19 |
| 7.2 GJETJET NË NJËSITË ADMINISTRATIVE | 20 |
| 7.2.1 Shërbimet Publike – Cilësia dhe Efiçenca | 20 |
| 7.2.2 Mirëqeverisja dhe Demokracia Vendore | 21 |
| 7.2.3 Zhvillimi Ekonomik Vendor | 21 |
| 7.2.4 Të drejtat e njeriut në nivel lokal..... | 21 |
| 7.3 PREMTIMET E MBAJTURA NË VITIN 2015 KUNDREJT REALIZIMEVE GJATË VITIT 2015 DHE 2016 22 | |
| 8. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME..... | 25 |
| 8.1 SHËRBIMET PUBLIKE – CILËSIA DHE EFIÇENCA | 25 |
| 8.2 TRANSPARENCA DHE MIRËQEVERISJA | 25 |
| 8.3 ZHVILLIMI EKONOMIK..... | 25 |
| 8.4 TË DREJTAT E NJERIUT NË NIVEL LOKAL | 25 |
| RRETH QENDRËS ALEANCA GJINORE PËR ZHVILLIM..... | 26 |

MIRËNJOHJE

Me mirënjohje falënderojmë të gjithë ata që ndihmuan në realizimin e këtij raporti për të vlerësuar qeverisjen vendore dhe gjithë qytetarët e Bashkisë Berat, të cilët morën pjesë aktive në aktivitet e realizuara përmes projektit dhe përmes argumenteve vlerësuan mirëqeverisjen lokale për bashkinë e tyre.

Një falënderim i veçantë i shkon z. Petrit Sinaj dhe stafit të tij, të cilët për dy vjet rresht morën angazhime konkrete përballë qytetarëve bazuar në sugjerimet e tyre për përmirësimin e punës në Bashkinë Berat.

Një falënderim gjithashtu shkon edhe për mbështetësit dhe financuesit e këtij projekti, Programit të Kombeve të Bashkuara për Gratë në Shqipëri, UN Women dhe Projektit të USAID për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP) për mbështetjen financiare dhe teknike gjatë zbatimit të projektit.

SHKURTIME

| | |
|----------|--|
| NJQV | Njësi të Qeverisjes Vendore |
| KKQV | Komisioni Këshillimor Qytetar Vendor |
| QAGJZH | Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” |
| RAT | Reforma Administrative-Territoriale |
| VKQ | Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen |
| UN Women | Programi i Kombeve të Bashkuara për Gratë |
| USAID | Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar |

1. HYRJJE

Ndërkohë që po bëhet progres për avancimin e procesit të decentralizimit në Shqipëri, sfidat për zbatimin me sukses të qeverisjes vendore të decentralizuar e demokratike janë të mëdha. Reforma Administrative-Territoriale (RAT) që filloi të zbatohet në qershor të vitit 2015, pati ndikim të konsiderueshëm në funksionimin dhe administrimin e njësive të qeverisjes vendore (NJQV). Zvogëlimi i numrit të NJQV-ve nga 373 në 61, çoi rrjedhimisht në rritjen ndjeshëm të territorit, popullsisë dhe kompleksitetit të funksionimit të tyre. Ndikimi i reformës është i madh, jo vetëm në aspektin e përgjegjësive dhe funksioneve të shtuara të njësive vendore, por edhe në ofrimin e shërbimeve me cilësi dhe efikasitet për qytetarët e bashkisë së zgjeruar tashmë. Paralelisht me këtë, bashkitë tani përballen me sfida edhe më të mëdha se më parë për të arritur informimin, përfshirjen dhe përfaqësimin e vërtetë të grave dhe burrave në vendimmarrje.

Në këtë kuadër, që prej vitit 2015, Projekti i USAID për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP) dhe UN Women, në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile dhe Komisionet Këshillimore Qytetare Vendore (KKQV) kanë ndërmarrë projektin e Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen (VKQ) në 10 nga bashkitë më të mëdha në vend. Në pritje të reformës dhe zgjedhjeve vendore të vitit 2015, VKQ u zbatua në bashkitë e Elbasanit, Beratit, Kamzës dhe Vlorës, ku gjetjet dhe rekomandimet e qytetarëve gra dhe burra u prezantuan dhe u përfshinë në axhendat dhe programet e kandidatëve për kryetarë bashkie. Këtë vit, VKQ u zbatua në gjashtë bashki të reja: Fier, Gjirokastrë, Kuçovë, Korçë, Lushnjë dhe Berat. Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen përfshin aspekte kryesore të qeverisjes vendore, të tilla si: (I) cilësia dhe efikasiteti i shërbimeve publike; (II) qeverisja e mirë dhe demokracia lokale; (III) zhvillimi ekonomik dhe (IV) të drejtat e njeriut në nivel vendor.

Përmes vjeljes së opinioneve të qytetarëve në identifikimin dhe përcaktimin e prioritetëve lokale, VKQ synon të krijojë dhe promovojë mekanizma qytetare në funksion të përmirësimit të demokracisë lokale. Procesi i VKQ mundëson monitorimin dhe vlerësimin e performancës së administratës lokale, paralelisht me ndërtimin e urave të dialogut, ndërveprimit dhe bashkëpunimit në nivel vendor.

Vlerësimi i komunitetit për qeverisjen është një qasje dhe mundësi e mirë që bashkitë të kuptojnë nevojat dhe përparësitë e qytetarëve. Harmonizimi dhe përfshirja e rezultateve të vlerësimit të komunitetit në programet vendore, si dhe përpjekja për të influencuar në hartimin e politikave vendore, janë një tregues pozitiv i demokracisë në veprim. Kombinimi i metodologjise se VKQ me aktorë kyç lokalë, të tillë si Komisionet Këshillimore Qytetare dhe organizata të shoqërisë civile kanë mundësuar zbatimin me sukses të këtij procesi.

2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Informacioni i përfshirë në këtë raport prezanton ecurinë e procesit të Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen në Bashkinë Berat në periudhën qershor-nëntor 2016 dhe përfshin vlerësimin nga ana e komunitetit dhe administratës vendore të performancës së shërbimeve të ofruara në nivel vendor, si dhe gjetjet dhe rekomandimet e ardhura nga qytetarët. Procesi i VKQ-së i ofron Bashkisë Berat një tablo të qartë të vlerësimit të qytetarëve në lidhje me shërbimet publike, zhvillimin ekonomik, funksionimin e demokracisë vendore dhe të drejtat e njeriut në nivel lokal.

Procesi i Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen u realizua nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (QAGJZH) në bashkëpunim me Bashkinë Berat, njësitë administrative Velabisht, Sinjë e Roshnik dhe komunitetit në njësitë e sipërpërmendura.

Projekti Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen u shtri në harkun kohor 2015-2016 dhe përfshiu 10 bashki, ndër të cilat edhe Bashkinë Berat. Qëllimi i këtij projekti është përmirësimi i demokracisë vendore përmes fuqizimit të mekanizmave qytetarë. Objektiva specifike të tij synojnë të nxisin ndërveprimin dhe dialogun mes qytetarëve dhe autoriteteve vendore, përmes përfshirjes së prioritetëve dhe nevojave të qytetarëve në programet dhe buxhetet vendore, duke krijuar kushte për përmirësim të qëndrueshme të shërbimeve që i ofrohen komunitetit dhe duke fuqizuar në këtë mënyrë bashkëpunimin midis të dyja palëve.

Për realizimin e VKQ u punua ngushtësisht me administratën e bashkisë për të siguruar gatishmërinë dhe bashkëpunimin e tyre në proces, gjë që kërkoi takime dhe diskutime paraprake në lidhje me metodologjinë, fushat që trajtonte VKQ, zonat e përzgjedhura për zbatim dhe pjesëmarrjen qytetare në të. Në bashkërendim me Bashkinë, VKQ përfshiu edhe njësitë administrative Velabisht, Sinjë e Roshnik.

Gjatë procesit të përpunimit të vlerësimeve janë konsultuar gjerësisht materiale, dokumente dhe strategji, të tilla si: buxheti i bashkisë për vitin 2016, Plani i Punës së Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020, Ligji 119/2014 Për të drejtën e Informimit, Ligji 135/2015 për Organizimin dhe Funksionimin e Vetëqeverisjes Vendore, faqja e internetit e bashkisë, etj.

Në këtë raport do të lexoni: 1) Një profil të shkurtër të Bashkisë Berat; 2) Metodologjinë e projektit; 3) Përshkrimin e projektit; 4) Përmbledhjen e rezultateve të vlerësimit të qytetarëve korçarë për qeverisjen vendore; 5) Gjetje e rekomandime për të ardhmen.

3. PROFILI I BASHKISË BERAT

Pozicioni gjeografik:

Bashkia e re Berat është e vendosur në Shqipërinë jug-qendrore dhe kufizohet në veri me bashkitë Kuçovë dhe Ura Vajgurore, në lindje me bashkinë Gramsh dhe Skrapar, në jug me bashkinë Poliçan, ndërsa në perëndim me bashkinë Mallakastër.

Popullsia:

Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re numëron 60.031 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil ajo numëron një popullsi prej 98.875 banorë. Bashkia e Beratit para zgjedhjeve lokale 2015 kishte një sipërfaqe prej 939 km², ndërsa sot bashkia e re ka një sipërfaqe prej 379.98 km².

Profili i bashkisë

Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Beratit. Kjo bashki përbëhet nga 5 njësi administrative, të cilat janë: Berat, Velabisht, Otlak, Sinjë dhe Rroshnik dhe ka nën administrimin e saj një qytet dhe 50 fshatra. Bashkia e re e Beratit, pas ndarjes së re territoriale, është një bashkim mes qytetit dhe katër ish-komunave në afërsitë të tij, duke gërshetuar kështu karakteristika nga më të larmishmet. Dy prej tyre, Velabisht dhe Otlak, janë zona kryesisht fushore dhe pjellore, ku të ardhurat kryesore sigurohen nga prodhimi i perimeve, ullinjve dhe vreshtarisë. Ndërkohë që dy njësitë e tjera administrative, Rroshnik dhe Sinjë, kanë reliev kodrinor-malor dhe të ardhurat kryesore sigurohen nga pemëtaria dhe blegtoaria.

Qyteti i Beratit, për shkak të historisë së tij mijëra vjeçare si zonë e banuar, mbart vlera historike dhe arkitektonike të rralla, duke u përfshirë kështu në vitin 2008 dhe në listën qyteteve muze të mbrojtur nga UNESCO. Qendra historike e qytetit, ku bëjnë pjesë tre lagjet muze "Kala", "Mangalem", "Goricë" dhe Qendra Mesjetare, përfshijnë rreth 490 monumente kulture. Vlerat historike, por dhe bukuria natyrore e qytetit të shtrirë përgjatë lumit Osum dhe rrëzë malit Tomor, po tërheqin gjithmonë dhe më shumë turistë përgjatë të gjitha stinëve, duke nxitur shumë nga banorët të kthejnë shtëpitë e tyre karakteristike në bujtina për turistët dhe duke shtuar të ardhurat nga turizmi.

Në kuadër të nxitjes së këtij sektori, vitin e kaluar qyteti përfitoi nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan investimin për pedonalen e qytetit, dhe po kështu u restaurua dhe Ura shekullore e Goricës, e cila ka sot një imazh të ri. Megjithatë, infrastruktura e qytetit, shërbimet dhe transporti publik kanë nevojë ende për shumë investime në mënyrë që të sigurojnë të ardhura të qëndrueshme nga turizmi.

Qyteti i Beratit, pas mbylljes së fabrikave dhe kombinatit të tij shumë vite më parë, tashmë i siguron të ardhurat kryesisht përmes turizmit, biznesit fason, si dhe prodhimeve dhe tregtimit të produkteve të konservuara, megjithatë nivelet e papunësisë mbeten të larta. Qyteti është karakterizuar dekadat e fundit nga një shpopullim i shpejtë si pasojë e mungesës së investimeve në infrastrukturë, gjë e cila është pasqyruar në lëvizjet e banorëve drejt qendrave më të mëdha urbane. Nga ana tjetër, gjatë të njëjtës periudhë ka pasur dhe një lëvizje më të vogël të popullatës nga zonat rurale drejt qytetit të Beratit. Komuniteti rom i këtij qyteti është i

mirëintegruar, por megjithatë mbeten pjesa më e prekur e popullatës nga problemet social-ekonomike, si papunësia, mungesa e strehimit, etj.

Ekonomia:

Ekonomia e qytetit është e fokusuar në tri shtyllat që sigurojnë qëndrueshmëri e rritje: infrastrukturë, turizëm dhe shërbime. Bashkia priret t'i investojë burimet e veta në shërbime, tregti me pakicë, artizanat, përpunim e agrobiznes, dhe turizëm. Sipas statistikave të faqes së bashkisë, të punësuar në sektorin publik janë 4775 dhe në sektorin privat 6234. Numri më i madh i bizneseve të vogla zhvillon tregtinë ambulante dhe atë të shërbimit. Numri total i subjekteve të biznesit të vogël pa ambulantët është 1106 dhe me ambulantët 1496 subjekte.

Në qytet ndodhen rreth 57% e agrobiznesit të rajonit, duke punësuar më shumë se gjysmën e numrit të të punësuarve 59%. Ka një rritje të industrisë së përpunimit të gurit, duke shfrytëzuar rezervave natyrore të zonës për materiale ndërtimi e gurë dekorative në Malin e Tomorit dhe rrethinat e tij.

Fasonët janë një drejtim tjetër i ekonomisë lokale, të cilat ngelen një industri që punëson kryesisht gra dhe një drejtim i rëndësishëm për një ekonomi lokale në zhvillim. Ka shumë biznese të tjera aktive në Berat, përfshirë industrinë që procedojnë me produktet ushqimore, të mishit, pijet alkoolike dhe jo-alkoolike ndërsa disa industri të manifakturës po tërheqin investime si ato të industrisë së lehte, ajo e materialeve të ndërtimit, punimet me dru, etj.

Përveç përpjekjeve të lavdërueshme, bashkia duhet të mbështesë dhe nxisë më tej turizmin historik dhe kulturor në qytetin e Beratit përmes lehtësimin e procedurave dhe politikave fiskale të banorëve për vetëpunësim në këtë fushë, ruajtjen e banesave muzeale nga erozioni dhe zjarret, por dhe ndalimi i ndërtimeve pa leje në qendrën historike. Gjithashtu, bashkia e re duhet të krijojë mundësinë e integritit të formave alternative të turizmit në zonat përreth qytetit, si ekoturizmi dhe turizmi i aventurës.

4. METODOLOGJIA

Procesi i Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen¹ është mjet monitorimi që përdor komunitetin si njësi analize për të nxitur llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë sociale dhe publike të institucioneve vendimmarrëse vendore. Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen njihet ndryshe edhe si “zëri i komunitetit”, pasi i mundëson qytetarëve të shprehin vlerësimin e tyre mbi cilësinë, përshtatshmërinë dhe eficientësinë e shërbimeve publike dhe të propozojë ndryshime në lidhje me shërbimet e ofruara, madje edhe mbi vendimmarrjet vendore. Mekanizmi i VKQ-së zbatohet në një nivel teje të rëndësishëm të qeverisjes, në atë vendor, ku qytetarët janë në kontakt më të drejtpërdrejtë me autoritetet vendimmarrëse dhe mbi të gjitha, me shërbimet e ofruara prej tyre.

Procesi mundëson krijimin e dialogut mes komunitetit dhe autoriteteve vendore, duke përballur mundësitë (burimet që kanë në dispozicion autoritetet vendore) me nevojat reale të komunitetit. Zbatimi i këtij mekanizmi në nivelin vendor ndikon në: zhvillimin e demokracisë me pjesëmarrje dhe arritjen e mirëqeverisjes vendore. Duhet të theksojmë gjithashtu se VKQ-ja nuk është thjesht një proces vlerësimi, pasi shkon përtej tij. Ajo ndërton ndërveprimin mes komunitetit, autoriteteve vendore, organizatave të shoqërisë civile etj, duke krijuar kushte për përmirësime të qëndrueshme të shërbimeve që i ofrohen komunitetit, duke e fuqizuar atë.

Gjatë procesit të VKQ-së parimet kryesore të vlerësimit të shërbimit (pavarësisht nga çështja objekt i VKQ-së) do janë:

- **Përshtatshmëria:** programi apo shërbimi a i reflekton nevojat e grupit të targetuar? A i respekton standardet dhe kriteret që përcakton ligji?
- **Efiçenca:** A po përdoren burimet (financiare, njerëzore, lokale) në mënyrë efektive dhe në kohën e duhur? A përfshihet komuniteti në planifikimin e këtyre burimeve?
- **Pjesëmarrja:** Sa dhe si nxitet pjesëmarrja e komunitetit në planifikimin dhe zbatimin e programit/shërbimeve? Cilat janë metodat që përdorin autoritetet për të nxitur pjesëmarrjen?
- **Qëndrueshmëria:** jetëgjatësia e programeve, shërbimeve. A janë fondet vjetore në rritje apo ato nuk ekzistojnë?
- **Rezultati:** Çfarë ndryshimesh ka sjellë zbatimi i programit/shërbimit? Çfarë rrugësh përdorin autoritetet për të matur ndikimin?

Përfituesit e Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen janë komuniteti dhe autoritet vendore. **Procesi i VKQ-së i mundëson komunitetit** të informohet mbi shërbimet që ofrohen nga autoritetet vendore; të shprehë opinionin e tij mbi cilësinë dhe eficientësinë e tyre; të monitorojë përmbushjen e detyrimeve/angazhimeve e tyre në ofrimin e shërbimeve cilësore; të shprehë drejtpërdrejtë tek autoritetet përkatëse opinionin e tij dhe t’u kërkojë atyre përmirësimet e nevojshme, si dhe të ndërveprojë me autoritetet përkatëse me qëllim përfundimin e shërbimeve cilësore e të qëndrueshme. **VKQ i jep mundësinë autoriteteve vendore** të njohin më mirë nevojat dhe prioritetet e komunitetit në përgjithësi, si dhe të grupeve të veçanta të tij; të orientojnë më mirë burimet që kanë në dispozicion në përputhje me këto nevoja dhe prioritete të

¹ Marrë nga Manuali për Shoqërinë Civile “Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen”- Mbështetur nga Njësia e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women), Shtëpia Botuese IDEART, 2012 Tiranë

komunitetit, të rrisin kapacitetet e tyre, transparencën në qeverisje dhe të përmirësojnë cilësinë dhe përshtatshmërinë e shërbimeve që i ofrojnë komunitetit.

Procesi i Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen realizohet përmes disa etapave, të tilla si: (1) Vlerësimi për ndjekjen e të dhënave (gjetja dhe konsultimi i dokumenteve, materialeve dhe strategjive që lidhen me Bashkinë); (II) Vlerësimi komunitar për performancën (fokus grupe me qytetare të Bashkisë në zonën urbane dhe rurale); (III) Vlerësimi ose vetë-vlerësimi nga ofruesit e shërbimeve (intervista gjysme të strukturuar me autoritetet lokale); (IV) Takimi i drejtpërdrejt midis përfituesve dhe ofruesve (prezantim publik i gjetjeve dhe rekomandimeve nga ky proces dhe (V) Përgatitja e raportit me qëllim institucionalizimin e procesin, advokimin dhe monitorimin.

5. PËRSHKRIM I PROJEKTIT

Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen 2015

Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen në Bashkinë Berat u shtri në periudhën 2015-2016. I organizuar në prag të zgjedhjeve lokale, procesi i VKQ në vitin 2015 angazhoi qytetarët e bashkisë Berat dhe të komunave që do të përfshiheshin në të pas riorganizimit nga Reforma Administrative-Territoriale. Nevojat dhe prioritetet e dala nga qytetarët iu prezantuan kandidatëve për kryetarë bashkie me synimin e përfshirjes së tyre në axhendat dhe programet elektorale, për t'u përkthyer më parë në programe dhe plane zhvillimore lokale.

Procesi u zhvillua përmes disa fazave, të cilat janë të detajuara si më poshtë:

Në fazën e parë u zbatua metodologjia e VKQ-së për nxjerrjen e prioriteteve të komunitetit (si burra edhe gra) në katër njësi administrative (atëherë bashkia Berat, dhe komunat Velabisht, Sinjë e Roshnik) sipas Reformës Territoriale. Gjatë kësaj faze, anëtarë të KKQV-së u informuan mbi procesin e VKQ-së si dhe për Reformën Administrative Territoriale. Në fokus-grupet e realizuara u nxorën problematikat e komunitetit sipas sistemit të vlerësimit.

Në fazën e dytë u punua me partitë politike dhe programet dhe platformat e tyre elektorale me anë të takimeve publike ndërmjet qytetarëve dhe kandidatëve për të adresuar prioritetet dhe problematikat e dala gjatë fazës së parë.

Gjatë fazës së tretë u realizuan debate qytetare nëpërmjet forumeve me kandidatët dhe fushatave ndërgjegjësuese.

Ndërsa **faza e fundit** u zbatua pas përfundimit të procesit zgjedhor, që u orientua rreth monitorimin dhe institucionalizimin e procesit të VKQ-së nëpërmjet trajnimeve të të zgjedhurve vendor dhe qytetareve.

Realizimi i këtij procesi në Berat jo vetëm që ishte i plotë, por ishte edhe unik në llojin e vetë. Dy kandidatët për kryetarë bashkie zhvilluan një takim të përbashkët publik me qytetarët, i cili ishte një model i qytetarisë dhe mënyrës sesi këto forume duhet të jenë. Kandidati për kryetar z. Petrit Sinaj (sot Kryetari aktual i Bashkisë) prezantoi platformën e tij dhe mori angazhime konkrete bazuar në rekomandimet e dala nga qytetarët në procesin e VKQ. Meqenëse rekomandimet e qytetarëve përbëjnë bazën e punës katër-vjeçare të Kryetarit të Bashkisë Berat, ekipi që realizoi këtë iniciativë, ka përgatitur një përmbledhje të progresit të bërë, bazuar në rekomandimet e vitit 2015 ndaj atyre të 2016, të cilat janë rekomandime afatgjata.

Vlerësimi i Komunitetit për Qeverisjen 2016

Për të parë ecurinë e këtij procesi të nisur në vitin 2015, ekspertët e projektit dhe Komisioni Këshillimor Qytetar Vendor Berat realizoi monitorimin e rekomandimeve që qytetarët kanë adresuar ndaj Bashkisë Berat, përmes zbatimit të së njëjtës metodologji për vitin 2016. Ndërkohë është realizuar krahasimi në lidhje me rekomandimet e qytetarëve në 2015 ndaj rekomandimeve të 2016. Rezultatet përdoren në nivel vendor për të kërkuar llogari dhe përgjegjshmëri nga autoritetet vendore.

Procesi u zhvillua përmes disa fazave, të cilat janë të detajuara si më poshtë






Skedat e vlerësimit: Faza përgatitore e projektit ishte shumë e rëndësishme për përcaktimin e aspekteve/fushave që do të mbulonte dhe treguesve që do të përmbante VKQ. Katër fushat e përzgjedhura ishin: (I) cilësia dhe efiçenca e shërbimeve publike, (II) qeverisja e mirë dhe demokracia lokale, (III) zhvillimi ekonomik dhe (IV) të drejtat e njeriut në nivel vendor. Bazuar në to u përcaktuan edhe 20 treguesit e performancës. U përgatitën tre lloje skedash specifike për qytetin, njësinë administrative dhe një përmbledhëse me vlerësimin e qytetareve dhe ofruesve të shërbimeve. Treguesit që u përdorën për Vlerësimin e Komunitetit për Qeverisjen janë:



Fokus grupet: Me synimin e marrjes së mendimit qytetar në muajin korrik u organizuan 4 fokus grupe me përfaqësues të komunitetit dhe banorë të qytetit Berat dhe njësitë administrative Velabisht, Sinjë e Roshnik. Në takime morën pjesë 60 pjesëmarrës (përfaqësues të OJQ, individë komunitarë që përfaqësonin grupe të marginalizuara, qytetarë aktivë, kryepleq fshatrash) të cilët me anë të pikëzimit vlerësuan performancën e bashkisë dhe identifikuan nevojat dhe prioritetet e qytetarëve. Në vlerësimin e komunitetit për qeverisjen procesi pati pjesëmarrje të balancuar gjinore 24 djem e burra dhe 36 vajza e gra. Gjatë realizimit të fokus grupeve me komunitetin, pjesëmarrësit u prezantuan me qëllimin dhe objektivat e projektit, informacione mbi zbatimin e Reformës Administrative-Territoriale, ndryshimi i kuadrit ligjor dhe mekanizmat që mbështesin pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje.

Intervista gjysmë të strukturuar: Pas takimit me qytetarët u organizuan intervista gjysmë të strukturuar me përfaqësues të bashkisë, ku u ofruesit e shërbimeve vetë-vlerësuan përmes sistemit të pikëzimit shërbimet që ata ofrojnë për komunitetin. Intervistat përfshinë drejtorinë e shërbimeve, drejtorinë e projekteve dhe administratorët e njësisë Velabisht, Sinjë e Roshnik. Shkalla e vlerësimit sipas pikëzimit që u përdor në Vlerësimin e Komunitetit për Qeverisjen si me qytetarët, ashtu edhe me bashkinë është si më poshtë:

| Kriteret | Pikëzimi |
|----------|----------|
|----------|----------|

| | | |
|---|---|------------------|
| Nuk ofrohet shërbim ose cilësia është shumë e dobët |  | 1-Shumë keq |
| Shërbimi ofrohet, por cilësia është e dobët |  | 2- Keq |
| Shërbimi ofrohet dhe është relativisht i mirë |  | 3- Çka (mesatar) |
| Shërbimi ofrohet me cilësi të mirë |  | 4- Mirë |
| Shërbimi ofrohet me cilësi të lartë |  | 5- Shumë mirë |

Analizimi i të dhënave: Moment shumë i rëndësishëm i VKQ është hedhja dhe analizimi i të dhënave nga fokus grupet dhe intervistat me ofruesit e shërbimeve. Gjatë kësaj faze është bërë edhe konsolidimi në një skedë i pikëzimit dhe gjetjeve nga qytetarët dhe ofruesit e shërbimeve. Pjesë thelbësore e punës ishte edhe konsultimi me dokumente/strategji dhe informacione të tjera që jepnin një ide me të qartë të fushave dhe treguesve të analizuar.

Prezantimi publik: Faza e fundit e VKQ në Bashkinë Berat ishte prezantimi publik i procesit të vlerësimit. Ai u organizua në formën e një forumi publik me qytetarët e Beratit. Përveç Zv. Kryetares së Bashkisë znj. Teuta Muçogllava dhe stafit të bashkisë, në takim morën pjesë edhe përfaqësues të Komisionit Këshillimor Qytetar, OJQ-ve që veprojnë në Berat, individë komunitarë që përfaqësonin grupe të marginalizuara, qytetarë aktivë, administratorë e kryepleq fshatrash të cilët morën pjesë në fokus grupet e organizuara. Takimi përfshiu një prezantim të gjetjeve nga ky proces, dhe në fund u ofruan rekomandimet që dolën nga takimet me qytetarët. Znj. Muçogllava vlerësoi procesin si një mundësi e mirë për të marrë mendimin e qytetarëve dhe si një formë e mirë për të rritur bashkëpunimin dhe dialogun me ta në të ardhmen. Rekomandimet do të merren parasysh në hartimin e buxhetit të vitit pasardhës, si dhe do të bëhen pjesë e dokumenteve strategjike që do të hartohen në vijim.

6. PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE

Siç u shpjegua më sipër në raport, në procesin e Vlerësimit të Komunitetit për Qeverisjen u përfshinë qytetarët e njësisë administrative qendër Berat dhe njësitë Velabisht, Sinjë e Roshnik. Çështjet për të cilat u bë monitorimi dhe vlerësimi ishin të ngjashme me ato që u diskutuan nëpër fokus grupet me komunitetin, në mënyrë që të merrej informacion për çështje të njëjta si nga komuniteti, në rolin e përfituesit të shërbimeve, ashtu edhe nga pushteti vendor në rolin e ofruesit të shërbimeve publike. Më poshtë keni rezultatet e dala dhe analizuara nga ky vlerësim.

- a) **Cilësia dhe efijenca e shërbimeve publike** - rrugë/ trotuare, ndriçim, pastrim, gjelbërim, furnizim me ujë të pijshëm dhe kanalizime, kanalet kulluese e ujitëse, pyjet e kullotat

| CILËSIA DHE EFIÇENCA E SHËRBIMEVE PUBLIKE | | |
|---|-----------------------|----------|
| | TË INTERVISTUARIT | PIKËZIMI |
| QYTET | Qytetarët | 3.3 |
| | Ofruesit e shërbimeve | 3.5 |
| NJËSI ADMINISTRATIVE | Qytetarët | 2.3 |
| | Ofruesit e shërbimeve | 3 |

- b) **Demokracia vendore – mirëqeverisja** – informimi dhe komunikimi, transparenca në vendimmarrje, pjesëmarrja në vendimmarrje

| DEMOKRACIA VENDORE – MIRËQEVERISJA | | |
|------------------------------------|-----------------------|----------|
| | TË INTERVISTUARIT | PIKËZIMI |
| QYTET | Qytetarët | 3.6 |
| | Ofruesit e shërbimeve | 4.5 |
| NJËSI ADMINISTRATIVE | Qytetarët | 2.8 |
| | Ofruesit e shërbimeve | 3.5 |

- c) **Zhvillimi ekonomik vendor** - planifikimi strategjik, nxitja e biznesit, nxitja e punësimit, mbledhja e të ardhurave dhe planifikimi i buxhetit

| ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR | | |
|----------------------------------|--------------------------|-----------------|
| | TË INTERVISTUARIT | PIKËZIMI |
| QYTET | Qytetarët | 3.5 |
| | Ofruesit e shërbimeve | 3.5 |
| NJËSI ADMINISTRATIVE | Qytetarët | 2.7 |
| | Ofruesit e shërbimeve | 3 |

- d) **Të drejtat e njeriut në nivel lokal** - gratë, grupe me nevoja të veçanta, romët dhe egjiptianët, mbrojtja nga diskriminimi

| TË DREJTAT E NJERIUT NË NIVEL LOKAL | | |
|--|--------------------------|-----------------|
| | TË INTERVISTUARIT | PIKËZIMI |
| QYTET | Qytetarët | 3.5 |
| | Ofruesit e shërbimeve | 3.5 |
| NJËSI ADMINISTRATIVE | Qytetarët | 2.3 |
| | Ofruesit e shërbimeve | 3 |

Përveç sistemit të pikëzimit pjesëmarrësit në vlerësim patën mundësinë të jepnin edhe komente e sugjerime/rekomandime. Më poshtë po rendisim disa prej gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore, që qytetarët dhe ofruesit e shërbimeve kanë bërë në Bashkinë Berat.

7. GJETJET KRYESORE

Një vështrim i thjeshtë krahasues mes zonës urbane dhe asaj rurale ndihmon për të kuptuar më qartë diferencat në shërbimet që ofrohen për banorët në territore të ndryshme të bashkisë. Procesi i vlerësimit ka treguar se diferencat aktuale brenda territorit të bashkisë vijnë në një masë të konsiderueshme nga mungesa e investimeve në ish-komunat në periudhën përpara reformës territoriale, por gjithsesi janë diferenca që duhet të adresohen në respekt të të drejtës së qytetarëve për të marrë të njëjtat shërbime, pavarësisht zonës ku banojnë. Ka diferenca mes qytetit dhe njësive administrative në buxhete, infrastrukturë, në nivelin e ofrimit të shërbimit dhe marrëdhënien me qytetarin, që janë sot sfida të vërteta të pushtetit vendor

7.1 GJETJET NË QYTET

7.1.1 Shërbimet Publike – Cilësia dhe Efiçenca

- Qytetarët vërejnë se trotuaret dhe hapësirat e raportuara të zëna mbeten përsëri të okupuara. Rrugët janë të hapura dhe punimet ecin shumë ngadalë.
- Pedonalja përmytet pas shiut edhe pse janë miliona lekë investime të bëra.
- Trotuaret e rrugës qendrore që po riparohet janë të vogla dhe qytetarët nuk i mendojnë shumë funksionale.
- Zhvendosja e plehrave bëhet gjashtë ditë në javë në qytet dhe tre herë në javë në njësiti administrative. Në qytet ka 354 kontenierë, por që janë pa kapakë dhe përbëjnë rrezik të përhapjes së infeksioneve.
- Qytetarët e pandërgjegjshëm i hedhin mbeturinat vend e pa vend dhe pushteti vendor duhet të përdori gjopa e penalizime për ta.
- Lumi është i ndotur edhe prej ujërave të zeza që përfundojnë në të.
- Bashkia ka bërë përpjekje për të gjelbëruar qytetin. Mirëmbahen parqet dhe janë zgjeruar sipërfaqet e gjelbëruara në lagjet muzeale dhe bedenat e mureve. Janë lyer pemët me gëlqere dhe janë mbjellë lule e trëndafila në lulishten në pedonalen e qytetit.

7.1.2 Mirëqeverisja dhe Demokracia Vendore

- Vendimmarrësit lokalë kanë ndërtuar metoda/sisteme për të informuar publikun mbi mbledhjet që janë të hapura për publikun. Megjithatë vendimmarrësit lokalë duhet të bëjnë më efikase mekanizmat që u mundësojnë qytetarëve të japin opinionin e tyre mbi mënyrën se si menaxhohet bashkia;
- Me gjithë politikat dhe programet specifike që nxisin përfshirjen e interesave të ndryshme, komuniteti mbetet ende indiferent dhe larg të qenit i gatshëm të marrë pjesë në vendimmarrje.
- Bashkia ka faqe në internet që informon komunitetin mbi qytetin, qeverisjen, administrimin dhe ekonominë lokale, por asnjë nga pjesëmarrësit e fokus grupeve nuk e dinte këtë fakt.
- Në faqen online publikohen informacione në ndihmë të qytetarëve, kopje aktesh, leje ndërtimi, njoftime për vende pune, publikime për investime të ndryshme, etj. Përmes plotësimit të një formulari në zyrën e informacionit qytetari mund të adresojë çdo kërkesë apo ankesë, e cila i përcillet kryetarit të bashkisë.

- Kabineti i kryetarit dhe sekretari i përgjithshëm marrin ankesat, të cilat u jepen drejtorive përkatëse për ndjekje, por qytetarët mendojnë se pushteti bën shumë pak për të informuar qytetarët, të cilët i përgjigjen me indiferentizëm dhe mospjesëmarrje. Kërkesat dhe ankesat e qytetarëve u vihen në dizpozicion këshilltarëve, dhe mbi 10-15 propozime të qytetarëve janë bërë realitet.
- Gjithashtu, qytetarët shprehen se këshilltarët duhet të shtojnë kontaktet me komunitetet që i kanë zgjedhur dhe me administratorët e njëjësive për problemet që i shqetësojnë. Këshilltarin e shohin si pikë lidhëse mes pushtetit dhe qytetarëve dhe zgjidhje problemesh. Qytetarët mendojnë se niveli i këshilltarëve është shumë i ulët, nuk ka ndonjë nismë të dalë prej tyre.
- Janë organizuar dëgjesa publike për projekt buxhetin dhe takime me qytetarë e grupe interesi për planin e territorit, por qytetarët pretendojnë se nuk dinë se ç'projekte ka, sa ndryshojnë rrugës, ku dhe si bëhen ndërhyrjet në buxhet. Ndërkohë ka shumë indiferentizëm dhe mungesë interesi nga qytetarët
- Marrëdhënia pushtet-qytetar mbetet sfidë. Bashkia ka bërë transparente investimet, por nga ana tjetër, qytetarët tentojnë t'i minimizojnë ato. Sipas tyre projektet ndryshojnë rrugës nga rreziqe të papritura dhe ankohen se asnjëherë këto nuk janë transparente dhe kërkojnë zbatim të afateve të firmave investuese. Qytetarët mendojnë që duhen informuar për shtyrje apo ndryshime afatesh. Nga media dhe kryetari janë bërë shumë sqarime, por ka indiferentizëm edhe ndaj mediave.

7.1.3 Zhvillimi Ekonomik Vendor

- Bashkia ka tendencë të investojë burimet e veta në shërbime, tregëti me pakicë, artizanat, përpunim e agrobiznes dhe turizëm.
- Përveç turizmit, fazonët janë një drejtim tjetër i rëndësishëm i ekonomisë lokale i cili mbetet një burim punësimi kryesisht për gratë.
- Ka shumë biznese të tjera aktive në Berat, përfshirë industrinë ushqimore (mishi, pijet alkoolike dhe jo-alkoolike), ndërsa disa industri të manufakturës po tërheqin investime, si ato të industrisë së lehtë, ajo e materialeve të ndërtimit, punimet me dru, etj.
- Ka një rritje të industrisë së përpunimit të gurit, duke shfrytëzuar rezervat natyrore të zonës për materiale ndërtimi e gurë dekorativë në Malin e Tomorit dhe rrethinat e tij.
- Numri më i madh i bizneseve të vogla zhvillon tregtinë ambulante dhe atë të shërbimit. Shuma totale e subjekteve të biznesit të vogël (pa ambulantët) është 1106 dhe me ambulantët 1496 subjekte.
- Në qytet ndodhen rreth 57% e agrobiznesit të rajonit, duke punësuar më shumë se gjysmën e numrit të të punësuarve (59%).
- Lehtësi në diferencim të taksave mes zonës muzeale dhe pjesës tjetër të qytetit, dhe mes qytetit e njëjësive administrative
- Informaliteti është ulur, ka shumë pak biznese të palicensuara. Ka vepruar ligji dhe ka ndërgjegjësim të tyre.
- Rinia vuan nga papunësia dhe kryesisht moshat 45-65 vjeç që nuk i punëson askush.

7.1.4 Të drejtat e njeriut në nivel lokal

- Në bashki funksionon drejtoria e shërbimit social. Në skemë janë 650 familje gjithsej. Numri i familjeve në skemën e ndihmës ekonomike është ulur nga viti në vit. Qytetarët mendojnë se është përmirësuar niveli i shërbimit të ndihmës ekonomike, por mendojnë se ka ende shumë më tepër nevojtarë

- Qytetarët nuk e njohin situatën e punësimit të grave vulnerabël, por pohojnë se ka nevojë që strukturat vendore të bashkëpunojnë me Zyrën e Punës, bizneset lokale dhe organizatat e shoqërisë civile për më shumë konkretizim të ndihmës për këtë kategori.
- Është ngritur mekanizmi i përbërë nga një specialiste e emëruar, e cila mbulon edhe ndihmën ekonomike dhe rastet e dhunës/barazinë gjinore.
- Referimi i rasteve të dhunës bëhet përmes urdhrin të mbrojtjes dhe ka bashkëpunim me policinë dhe gjykatën. Pas referimit të rasteve, mblidhet tryeza e përbashkët. Ka 4 raste të trajtuara këtë vit.
- Ka informim dhe ndërgjegjësim në lidhje me dhunën ndaj gruas, por nuk ka linjë telefonike të dedikuar dhe nuk ka qendër strehimi.
- Ka një qendër ditore për fëmijët PAK. Ka dhe dy qendrat rezidenciale me kushte cilësore. Është ndërtuar një qendër komunitare me financim të BE ku përfshihen: kopsht; konsultore; klinikë stomatologjike me shërbim falas; librat falas i ofroi shteti.
- Bashkia Berat është përfitues i një projekti tre vjeçar nga UNDP për punësimin dhe regjistrimin e komunitetit rom, rikonstruksionin e një çerdheje dhe ndërtimin e një kopshti të ri.
- 38 familje rome dhe 170 familje egjiptiane përfitojnë ndihmë ekonomike. 24 familje egjiptiane janë strehuar në banesa sociale. Gratë egjiptiane janë punësuar në fasoneri.

7.2 GJETJET NË NJËSITË ADMINISTRATIVE

7.2.1 Shërbimet Publike – Cilësia dhe Efiçenca

- Pjesëmarrësit mendojnë se situata e **rrugëve** nuk ka ndryshuar krahasuar me një vit më parë. Qendra e Roshnikut është me rrugë të mira, ndërsa rrugët lidhëse me fshatrat e tjerë të njësisë janë problematike. Ka kujdes për mirëmbajtjen e të vetmes rrugë që kanë.
- Ka rrugë fshatrash të pakalueshme si Kostren, Plashnik i Vogël, Vojnik. Problem janë rrugët e arave
- Ujërat e padisiplinuar rrjedhin rrugëve dhe i prishin më tej ato. Edhe nëse rrugët janë të mira, me kalimin e kohëve degradojnë për shkak të ujitjes së kopshteve personale dhe lënies së ujit të rrjedhë pa kriter
- Duan mirëmbajtje të rrugëve dhe shtim të kapaciteteve njerëzore mirëmbajtëse
- Transporti i prodhimeve bujqësore është shumë problem
- Në lidhje me **pastrimin**, ka kosha vetëm në qendrat e njësisë
- **Kanalet kulluese:** Në njësinë administrative Velabisht u bë pastrimi i afërsisht 1000 ml kanaleve, nga i të cilit pritet të shtohet ujitje në 50 ha tokë dhe përfitojnë 100 fermerë. Gjithashtu është kryer pastrimi i kanalit ujitës Velabisht-Veterik me gjatësi 7000 ml dhe prurje 350 l/s, nga i cili përfituan ujitje 150 ha tokë bujqësore fshatrat Velabisht, Starovë, Remanicë, Veterik. Bashkia për t'i ardhur në ndihmë fermerëve ka bërë të mundur gjatë vitit 2015 investime në kanalet ujitëse: kanali ujitës Bilçë me një gjatësi 13 km.
- Është realizuar pastrimi i kanalit ujitës Velabisht-Veterik me gjatësi 7000 ml, nga i cili përfitojnë ujitje 150 ha tokë bujqësore. Kanali ujitës Gjeroven-Starovë me gjatësi 7200 ml për herë të parë u vu në funksion të plotë dhe bashkia bëri të mundur pastrimin dhe riparime të pjesshme në gjithë gjatësinë e tij. Nga kjo mirëmbajtje përfitojnë ujitje 100 ha tokë të fshatrave Gjeroven, Velabisht, Starovë.

- U bë gjithashtu i mundur pastrimi i kanalit ujitës Ullinjas me gjatësi 4200 ml nga mbushja me aluvione dhe riparime të pjesshme në të gjithë gjatësinë e tij. Nga ky investim përfitojnë ujitje 50 ha tokë bujqësore.
- U bë e mundur mirëmbajtja e të gjithë kanaleve dytësore në Zonën e Orizaj dhe Lapardhasë, nga të cilët përfituan ujitje gjithë fushat e fshatit Orizaj me rreth 100 ha dhe fshatit Lapardha me një sipërfaqe total 200 ha tokë bujqësore.
- U bë i mundur pastrimi i 5000 ml në fshatrat Bilçë, Dyshnik, Moravë dhe aktualisht puna është fokusuar në Starovë ku po punohet me intensitet.

7.2.2 Mirëqeverisja dhe Demokracia Vendore

- Pjesëmarrësit mendojnë se e kanë mundësinë të marrin çdo lloj dokumenti a informacioni që duan në kohë.
- Ata shprehen se administratori është i gatshëm dhe i hapur t'i ndihmojë në çdo kohë.
- Në përgjithësi shprehen se kanë marrë pjesë në konsultime, takime, informime për problemet e njësisë.
- Të rinjtë pjesëmarrës mendojnë që njësia administrative duhet të jetë më pranë shkollës dhe t'i përfshijë ata nëpër veprimtari. Ata nuk e dinë që janë bërë debate publike.

7.2.3 Zhvillimi Ekonomik Vendor

- Pjesëmarrësit nuk e dinë nëse ka plan strategjik për zhvillimin e zonës; disa mendojnë se ai duhet të jetë pjesë e planit të bashkisë së madhe.
- Disa pjesëmarrës kanë dëgjuar se rëndësi në planifikim do t'i jepet zhvillimit të turizmit dhe rrugës që kalon përmes Bogdanit për në Gramsh. Turizmin e shohin si burim të ardhurash dhe ulje varfërie.
- Agrobiznesin e konsiderojnë gjithashtu burim të ardhurash, veçanërisht fikun e Roshnikut, vreshtarinë, pemëtarinë, ullirin, aroret.
- Janë krenarë për Parkun Kombëtar të Tomorit; kanë dëgjuar që do ketë shumë turizëm prej tij, por ende s'ka një rrugë që të çon atje dhe s'po shohin asnjë lloj të ardhure prej tij.
- Të rinjtë janë indiferentë. Ata shprehen se nuk janë të interesuar për këtë çështje, nuk mendojnë se idetë e tyre do të bënin ndonjë ndryshim, sepse do të shkojnë në shkollë të lartë dhe nuk do të kthehen më në fshat.
- Varfëria është plagë, papunësia ka prekur të rinjtë, ku rreth 50 % janë në emigracion. Ata që janë këtu e shohin perspektivën ende të zymtë.
- Shumica janë të vetëpunësuar në bujqësi dhe blegtori, përmes të cilave krijojnë të ardhura që shpesh janë të pakta.

7.2.4 Të drejtat e njeriut në nivel lokal

- Qytetarët mendojnë se numri i familjeve që janë përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike është i ulët. Ka shumë më tepër të varfër se ata që janë në skemë, por ligji mbi pronësinë e tokës i ka komplikuar jetët e banorëve, duke lënë jashtë skemës plot familje nevojtare.
- Perceptimi i pjesëmarrësve është që gratë në përgjithësi dhe, gratë vulnerable në veçanti, janë lënë pas dore.
- Moshja e tretë është pa pension social, ndërkohë që ka familje që janë në gjendje varfërie dhe të sëmurë invalid pa asnjëfarë lloji ndihme.

7.3 PREMTIMET E MBAJTURA NË VITIN 2015 KUNDREJT REALIZIMEVE GJATË VITIT 2015 DHE 2016

| PREMTIMET | REALIZIMET |
|--|--|
| <p style="text-align: center;">Shërbimet publike</p> <ul style="list-style-type: none"> • Menaxhim më të mirë të ujërave të larta dhe sigurim të ujit të pijshëm për komunat Velabisht dhe Roshnik • Lidhja e fshatrave me qendrat e komunave me rrugë të asfaltuara dhe ndriçim të fshatrave brenda mandatit • Rregullimi dhe sistemimi i rrugës nga Gjykata deri tek Bashkia, nga Pedonalja deri tek Ura e Goricës, si edhe rrugëve përmes lagjeve dhe në periferi • Menaxhim i integruar i mbetjeve urbane, dhe zhvillim projektesh për riciklim të tyre • Sistemimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve në gjithë territorin e bashkisë Berat • Do të vazhdojë rregullimi i qendrave të lagjeve, lyerja e fasadave, proces që do të përfundojë brenda mandatit • Ndërtimi i By-passit (tuneli në lagjen Goricë si dhe ura e re që lidhin fshatin Bilcë me Uznovën) që do të çlirojë arteriet e Beratit • Rikonstruksioni i segmentit Universiteti i Beratit-Uznovë që do përmiresojë lëvizjen e automjeteve dhe do t'i japë jetë Tregut Industrial <p style="text-align: center;">Shërbimet Sociale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Strategji të re për zbatim të shërbimeve të integruara për grupet në nevojë • Lehtësim të taksave e tarifave për grupet vulnerabel | <p style="text-align: center;">Shërbimet publike</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rikonstruksion i Sheshit Agjensia dhe fasadat e lagjes aty • Rikonstruksion i rrugës "Muzak Topia" dhe "Agron Elezi", i Shetitores Osumi dhe rehabilitimi i fasadave përgjate bulevardit kryesor • Rikualifikim i fasadave përgjate gjithë rrugës "Antipatrea" • K.U.Z fshati Lapardha dhe K.U.Z fshati Mbreshtan • Vazhdimi i pedonales nga sheshi kryesor deri tek Stadiumi i Vjetër dhe rruga Stadiumi i Vjetër • Parmakët, ndriçimi dhe riveshja e rrugës Ura e varur - Ura e Goricës me vlerë mbi 60 milionë lekë. • Rivitalizim i parkut perëndimor të qendrës • Rindërtimi i trotuarit dhe parmakëve nga Ura e Varur-Ura e Gorices • Është kryer rindërtimi i parkut "D. e Kombit" • Rikonstruksion i bibliotekës "Vehxhi Buharaja" <p style="text-align: center;">Shërbimet Sociale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Është caktuar një administrator për cdo 250 familje • Është në shërbim një punonjës social në çdo njësi administrative • Janë krijuar lehtësira për shërbimet ndaj |

| | |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • Ofrim shërbimesh falas për nënat e divorcuara, vajzat nëna, të vejat, duke ofruar çerdhe, kopshte e pagesa për mjete shkollore për fëmijet e tyre duke i lënë hapësire nënave të punojnë • Krijim i partneriteteve me shoqëri civile e donatorë për ndërgjegjësim dhe programe të barazisë gjinore, dhunën në familje, policimin në komunitet, sigurinë rrugore, bashkëjetesën fetare e etnike, etj • Ndërtim shkollash, kopshtesh e çerdhesh të reja | <p>PAK në bashkëpunim me bankat e nivelit të dytë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Janë krijuar partneritete me ambasada e shoqata të shoqërisë civile në ndihmë të njerëzve në nevojë • Janë përmirësuar kushtet në çerdhe, kopshte e shkolla. Është bërë hidroizolim i taracës së Kopshtit 28 Nëntori”, rikonstruksioni i shkollës “Ajet Xhindole” |
| <p style="text-align: center;">Mirëqeverisja dhe transparenca</p> <ul style="list-style-type: none"> • Do të vazhdojë procesi i konsultimeve me qytetarin sidomos pas leximit të SVK me problematikat që ajo ka nxjerrë. • Do të bashkëpunohet me zyrën e punës për thithjen e fondeve për nxitje punësimi dhe vetëpunësimi • Nëpërmjet administratorëve në komuna do të sigurohet informacion i plotë | <p style="text-align: center;">Mirëqeverisja dhe transparenca</p> <ul style="list-style-type: none"> • Janë bërë 14 dëgjesa publike për Planin e Përgjithshëm Vendor të Territorit • Janë bërë dëgjesa ne njësitë administrative me pjesëmarrjen e kryetarit të bashkisë • One Stop Shop qe po ngrihet me mbështetjen e USAID |
| <p style="text-align: center;">Zhvillimi ekonomik</p> <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i një regjistri të tokës dhe zgjidhja e problemit të certifikatave të pronësisë aty ku është prezent • Investime dhe subvencione në bujqësi, rrjete për vaditje-kullim, si pjesë e zhvillimit ekonomik të zonave që i bashkohen Bashkisë së Beratit • Koordinim me ministritë e linjës dhe donatorët për zhvillimin e agropërpunimit, turizmit, kulturës, bujqësisë dhe blegtorisë • Lehtësim i taksave e tarifave për bizneset me qëllim që ata të hapin vende të reja pune • Ulje e taksave për biznesin e vogël dhe | <p style="text-align: center;">Zhvillimi ekonomik</p> <ul style="list-style-type: none"> • Informatizim i sistemit të taksave dhe tarifave vendore (për biznesin) dhe për financën (TAIS dhe FAIS). Sistemi TAIS është vënë plotësisht në punë për pjesën e biznesit. • Hartimi i Planit të Përgjithshëm Rregullues me asistencën e USAID • Hartimi i paketës fiskale dhe të buxhetit vendor 2015 me asistencën e USAID • Lehtësim tarifash e taksash për zonat muzeale, takse e ulët për biznesin artizan të grave në qytet dhe ofrim ambjentesh falas, është ndërmjetësuar nga bashkia në biznesin fason për punësim grash • Përrjashtim nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin i bizneseve të vogla me qarkullim vjetor 0-5 |

| | |
|---|--|
| <p>atë të mesëm në masën 30-50%</p> <ul style="list-style-type: none"> Promovimi i turizmit Kulturor, malor dhe të aventurës, rritja e numrit të shtretërve, rivitalizimi i Parkut Kombëtar të Tomorrit dhe paisja e tij me gjithë infrastrukturën e nevojshme; ngritja e fshatrave turistike në Tomorr e Shpirag, si atraksione turistike dhe burime punësimi | <p>milione lekë dhe uljen e shkallës tatimore për ato me qarkullim vjetor 5-8 milion lekë.</p> <ul style="list-style-type: none"> Rritje të numrit të shtretërve. Pastrimi i afërsisht 1000 ml kanaleve Velabisht Pastrimi i kanalit ujitës Velabisht – Veterik me gjatësi 7000 ml Kanali Ujitës Bilçë me një gjatësi 13 km vihet në funksion në gjithë gjatësinë e tij Kanali Ujitës Gjeroven – Starovë me gjatësi 7200 ml; pastrimin dhe riparime të pjesëshme në gjithë gjatësinë e tij. Kanali Ujitës Ullinjas me gjatësi 4200 ml, riparime të pjesëshme në të gjithë gjatësinë e tij. Kanalet ujitës në zonën Orizaj dhe Lapardha, mirëmbajtja e gjithë kanaleve dytësore. Pastrimi i 5000 ml në fshatrat Bilçë, Dyshnik, Moravë |
| <p>Të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore</p> <ul style="list-style-type: none"> Ofrimi i shërbimeve sociale pranë territorit të komunës (në çdo ish qendër komune) Respektimi i tyre dhe mbështetje sociale dhe ekonomike | <p>Të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore</p> <ul style="list-style-type: none"> Është ndërtuar një qendër komunitare me financim të BE ku përfshihen: kopsht; konsultore; klinikë stomatologjike me shërbim falas; librat falas i ofroi shteti. Bashkia Berat është përfitues i një projekti tre vjeçar nga UNDP për punësimin dhe regjistrimin e komunitetit rom, rikonstruktionin e një çerdheje dhe ndërtimin e një kopshti të ri. 24 familje egjiptiane janë strehuar në banesa sociale. Gratë egjiptiane janë punësuar në fasoneri. |

8. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

8.1 Shërbimet Publike – Cilësia dhe Efiçenca

- Të rriten investimet për shërbimet: rrugë periferike e trotuare në shërbim të fëmijëve e qytetarëve; ndriçim më të mirë në periferi e fshatra; të lirohen hapësirat publike, veçanërisht trotuaret; të bëhen rrugët lidhëse në njësitë administrative, të shtohen kosha plehrash në njësitë administrative dhe të përmirësohen kanalizimet e rrjeti i ujësjellësit
- Përmirësim të infrastrukturës së kopshteve, veçanërisht në njësitë administrative; shtrirje e tyre në fshatra e më pranë rrugës, që të bëhen lehtësisht të aksesueshme nga fëmijët

8.2 Transparenca dhe Mirëqeverisja

- Të përmirësohen mekanizmat për mbajtjen hapur të kanalit për komunikim me qytetarët
- Të jenë transparente afatet, ndryshimet e ndërrimet e rrugëve në projekte e gjithë transformimet që ndodhin në infrastrukturën e qytetit
- Të jepet llogari e vazhdueshme në takime të hapura të kryetarit të bashkisë dhe stafit të tij, veçanërisht në njësitë administrative

8.3 Zhvillimi ekonomik

- Të zbuten penalizimet për fermerët në rast mospaguarje të taksave, sepse nuk mungon dëshira, por mundësia dhe të rishikohen në rast se paguajnë për shërbime që nuk i marrin
- Të përsosën mekanizmat për mbledhjen e të ardhurave dhe të bëhet transparent destinacioni i tyre
- Të rriten investimet në njësitë administrative për të siguruar lidhjen e fermerëve me tregjet e shitjes së prodhimeve bujqësore e blegtorale
- Të rriten investime dhe bashkëpunime për punësim të rinjsh dhe grash që sjell rritje të dinjitetit njerëzor

8.4 Të drejtat e njeriut në nivel lokal

- Të ngrihen kapacitete dhe të trajnohet stafi i bashkisë për efektivitet të punës me këto kategori njerëzish
- Ligjet ekzistuese të shoqërohen me buxhete të caktuara në ndihmë të njerëzve në nevojë dhe mbrojtjes së të drejtave të grave strukturat vendore të bashkëpunojnë me Zyrën e punës, bizneset lokale dhe organizatat
- Shtrirje të veprimtarisë së donatorëve dhe shoqërisë civile edhe në njësitë administrative
- Njësitë administrative të kenë një bibliotekë, ambiente sportive dhe një qendër për argëtim dhe kalimin e kohës së lirë.

RRETH QENDRËS ALEANCA GJINORE PËR ZHVILLIM

E themeluar në vitin 1994, Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC) është një organizatë jo fitimprurëse, jo partiake, me mbi 20 vjet eksperiencë në punë kërkimore, edukim publik, asistencë për zhvillim kapacitetesh, monitorim dhe avokim. GADC promovon zhvillimin demokratik dhe mirëqeverisjen me një fokus të veçantë në çështjet e barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale. GADC është një organizatë lider në Shqipëri dhe në rajon, e mirënjohur për rolin e saj në prezantimin e çështjeve të rëndësishme në lidhje me të drejtat e grave, siç është dhuna me bazë gjinore dhe trafikimi i personave.

GADC është e njohur për zhvillimin e metodologjive të ndryshme për fuqizimin përmes zhvillimit ekonomik të grupeve vulnerabël, avokimit për çështje themelore ligjore e politika të rëndësishme siç janë Ligji “Për dhunën në marrëdhëniet familjare” apo “Ligji kundër diskriminimit”, Barazia Gjinore apo përfaqësimi i grave në politikë e vendim marrje. Prezantimi i çështjeve të buxhetimit gjinor në nivel lokal dhe qendror si dhe përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje janë dy çështje për cilat GADC ka zhvilluar e zbatuar metodologji të veçanta të cilat sollën ndryshime të rëndësishme që adresojnë pabarazitë dhe përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël në Shqipëri.

Që nga fillimi GADC ka zbatuar shumë projekte, të cilat kanë ndikuar në jetët e qindra pjesëmarrësve në aktivitetet e zhvilluara në të gjithë Shqipërinë. GADC ka një historik të gjatë bashkëpunimi të suksesshëm me aktorë të ndryshëm, përfshirë një numër të madh organizatash shqiptare, institucionesh publike në nivel qendror e lokal, rajonal dhe ndërkombëtar, sektorit privat, medias, akademisë etj. Disa nga aktorët kyç partnerë të GADC-së janë UNWomen, UNDP, EU, US Embassy, USAID, OSCE, Dhoma të Tregëtisë, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, bashki të ndryshme etj.

GADC fuqizohet në punën e saj nga rrjeti i gjerë i bashkëpunëtorëve, ekspertëve dhe trajnerëve kombëtarë e ndërkombëtarë me formim të pasur akademik. GADC punon të shpërndajë sa më shumë informacion dhe të kthehet në një platformë për ndarje eksperiencash e njohurie me të gjithë e në të gjithë vendin.



VLERËSIMI I KOMUNITETIT PËR QEVERISJEN

RAPORT BASHKIA BERAT